

Në bazë të nenit 116 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit të sigurimit pensional dhe invalidor ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 98/2012275/2019) dhe nenit 4 të Rregullores për punën e Këshillit të Organizatës së regjistruar për fondin solidar dhe anëtarësimin nr. 03-06/420 prej 4.7.2014, Këshilli në seancën e mbajtur më 29.04.2021 solli:

VENDIM

mbi përcaktimin e përkohshëm të lartësisë së mbajtjes për fondin solidar – ndihmë e pas vdekjes, anëtarësimin dhe lartësinë e pagesës së ndihmës së pas vdekjes

Neni 1

Lartësia e mbajtjes për fondin solidar – ndihmë e pas vdekjes arrin 140,00 denarë për periudhën prej 1 qershorit deri më 31 dhjetor të vitit 2021, për shkak numrit të rritur të shfrytëzuesve të ndjerë të pensionit, me qëllim të pagesës në kohë të ndihmës së pas vdekjes për anëtarët e familjes të pensionistit të ndjerë.

Neni 2

Lartësia e pagesës së ndihmës së pas vdekjes e cila u paguhet anëtarëve të familjes së pensionistit të ndjerë arrin 30.000 denarë.

Neni 3

Për anëtarësim në shoqatën e pensionistëve (taksë anëtarësie) lartësia e taksës së anëtarësisë arrin 30,00 denarë.

Neni 4

Me këtë vendim pushon të vlejë Vendimi për lartësinë e mbajtjes për fondin solidar – ndihmë e pas vdekjes, anëtarësimin dhe lartësia e pagesës së ndihmës së pas vdekjes ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 17/2021).

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e shpalljes në Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, ndërsa do të zbatohet prej 1 qershorit deri më 31 dhjetor të vitit 2021.

Këshilli i Organizatës së regjistruar për
fondin solidar dhe anëtarësim
Kryetarë,
Mentor Qoku